

Tirane me 23.05.2023

## KËRKESË ANKIMORE



**Drejtuar:** Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve

**Adresa:** Rruga " Ibrahim Rugova", Nderresa nr.4: Tiranë

**ANKUESI:** PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPERISE

**Adresa:** RRUGA "SKENDERBEJ" TIRANE nr. i telefonit: 0692040472

**OBJEKTI :** KUNDERSHTIMI I VENDIMIT TE KOMISIONERIT SHTETEROR TE ZGJEDHJEVE  
**Vendimi NR ; 541 DATE 20.05.2023**

**TITULLI I VENDIMIT:** PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA VLORË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

**BAZA LIGJORE:** Bazuar në nenin **124** dhe **126**, neni **160**, pika 2 dhe 3, neni **161**, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### SHKELJA E PRETENDUAR DHE PASOJA E TYRE

Duke qene se nga ana e KZAZ eshte njoftuar verbalisht me telefon subjekti PSD Vlore se numerimi i votave per Keshillin Bashkiak Vlore do te fillonte ne daten 15.05.2023 ora 14:00 dhe nderkohe ky numerim ka vijuar menjehere pas numerimit te votave per Kryetarin pra ne oren 10:00 te kesaj date, nuk eshte bere e mundur prezenca e vezhguesve te subjektit tone gjate numerimit.

Ne keto kushte subjekti ankues ka marre informacion nga perfaqesuesit e tij ne KZAZ se sipas vleresimit dhe informacioneve qe ata disponojne ne kete KZAZ eshte deformuar rezultati i votave te numeruara dhe shperndarja e tyre tek subjektet elektorale pjesemarrese ne zgjedhje sa i takon leximit e per pasoje edhe shperndarjes se gabuar te votave ne eventualitet te ngaterrimit te siglave te subjekteve PSD dhe PDS (per shkak te ngjashmerise se tyre ) apo ne rastin me te keq edhe nepermjet veprimeve te qellimshme te anetareve te GNV-ve te kesaj KZAZ-je.

Sipas pretendimit te zyres elektorale te subjektit tone ne qytetin e Vlores rezulton te jete ndryshuar apo me sakte numri i votave te vlefshme te shperndara subjektit tone eshte me i vogel se numri faktik i tyre se paku ne 26 qendra votimi ku perkatesisht na rezulton nje mosperputhje midis votave si me poshte:

QV	VOTA TE DEKLARUARA NGA GNV	VOTA TE MUNGUARA
4440-01	0	16
4399-00	0	4
4400-00	2	4
4405-01	1	5
4515-01	0	5
4417-00	0	8
4411-01	1	5
4411-01	0	5
4411-01	0	4

Adresa:  
Pallati i Kongreseve,  
Blvd. Dëshmoret e Kombit,  
Tiranë,  
Tel./Fax:  
+355 (4) 23 53 63  
Website: www.cec.org.al  
E-mail:  
infosec@cec.org.al



4426-00	0	8
4539-00	0	2
4539-01	0	3
4542-01	0	10
4547-00	6	6
4547-01	4	6
4432-00	1	4
4433-00	0	5
4436-00	0	2
4446-01	0	3
4447-00	0	5
4449-01	2	4
4450-01	0	4
4451-00	0	6
4452-00	6	6
4453-00	6	4
4454-00	1	7
<b>Totali</b>		<b>141</b>

Pra janë gjithsej 26 QV, votat e të cilave janë lexuar dhe shpërndarë në mënyrë të gabuar duke ju hequr padrejtësisht subjektit të tyre elektoral.

Në 15 nga këto qendra nuk rezultojnë as votat e antareve të KQV-ve që janë përfaqësues të PSD si dhe në një pjesë të mirë të tyre mungojnë edhe votat e familjeve të tyre.

Në total rezultojnë 141 vota të munguara për llogari të subjektit të tyre.

Nëse do të referohemi të dhënat në lidhje me shpërndarjen e mandateve, sipas raporteve aktuale të percaktuara nga votat e vlefshme të shpërndara për secilin subjekt, rezultojnë se diferenca e mesipërme ndikon në shpërndarjen e mandateve të keshilltareve të Keshillit Bashkiak Vlorë, duke i mohuar në këtë mënyrë një mandat keshilltari subjektit ankues PSD.

Për këtë arsye kërkojmë rinumerimin e votave të Keshillit Bashkiak në 26 kutitë e mesipërme, ndryshimin e rezultatit të miratuar nëpërmjet vendimit nr 541 datë 20.05.2023 të KSHZ duke pasqyruar rezultatet e rinumerimit të këtyre kutive në tabelën përmbledhëse dhe duke vendosur/urdhëruar edhe ndryshimin e kësaj tablele sipas rezultateve të rinumerimit.

### **FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBESHTETET ANKIMI.**

Bazuar në vendimet e KQZ subjekti elektoral PSD ka patur të drejtën e emerimit të një antari në cdo KQV e për pasojë cdo KQV ka patur në përberjen e saj nga 1 antar si përfaqësues i PSD. Nga verifikimi i rezultateve të pasqyruara nga GNV-të përkatëse rezultojnë se në 15 nga qendrat e votimit të mesipërme nuk rezultojnë as vota e antareve të PSD e në një pjesë të tyre nuk figurojnë as votat e familjeve të tyre të cilat janë prezantuar hapur gjatë fushatës elektorale si mbështetës të forcës të tyre politike.

Adresa:  
Pallati i Kongreseve,  
Blvd. Dëshmoret e Kombit,  
Tirane,

Tel./Fax:  
+355 (4) 23 53 63

Website: [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al)

E-mail:  
[infocec@cec.org.al](mailto:infocec@cec.org.al)



**PROVAT QË PARAQITEN  
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE**

Ne funksion te shqyrtimit te ketij ankimi kerkojme qe te administrohen per qellim te rinumerimit kutite me fletet e votimit per Keshillin Bashkiak Vlore perkatesisht kutite e qendrave te votimit me numer 4399-00, 4400-00, 4405-01, 4417-00, 4418-00, 4419-01, 4424-01, 4426-00, 4432-00, 4433-00, 4436-00, 4440-01, 4446-01, 4447-00, 4449-01, 4450-01, 4451-00, 4452-00, 4453-00, 4454-00, 4515-01, 4539-00, 4539-01, 4542-01, 4547-00, 4547-01, rregjistrimet e kamerave gjate procesit te numerimit si dhe tabelat e rezultateve te numerimit te firmosura nga GNV-te per keto qendra votimi.

**Bashkëlidhur Vendimi nr. 541 , date 20 . 05 . 2023**

**ANKUESI**

**PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPERISE**

---

Kërkesë ankimore

Adresa:  
Pallati i Kongreseve,  
Blvd. Dëshmoret e Kombit,  
Tirane,  
Tel./Fax.  
+355 (4) 23 53 63  
Website: www.ccc.org.al  
E-mail  
infosec@ccc.org.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.5.2023

Nr: 541

Ora: 19:00

VENDIM  
PËR

MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR  
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA  
VLORË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 4 (katër) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 83, ZAZ nr. 84, ZAZ nr. 85 dhe ZAZ nr. 86.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Data: 20.5.2023 Nr: 541



"Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 83, KZAZ nr.84, KZAZ nr. 85 dhe KZAZ nr. 86 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Vlorë dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Vlorë, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 83, ZAZ nr. 84, ZAZ nr. 85 dhe ZAZ nr. 86, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Vlorë, Qarku Vlorë, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

### **VENDOS:**

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Ermal Dredha si Kryetar i Bashkisë Vlorë, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Vlorë, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



## ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

### TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

#### BASHKIA VLORË, QARKU VLORË

Lidhja 1

	ZAZ 83	ZAZ 84	ZAZ 85	ZAZ 86	TOTALI
1 Nr Zgjedhëse në listë	46.084	38.347	41.734	41.523	167.688
2 Fletë votimi të gjetura në kuti	10.281	9.789	10.153	11.274	41.497
3 Vota të pavlefshme	309	368	299	382	1.358
4 Vota të vlefshme	9.953	9.401	9.839	10.880	40.073
5 Fletë votimi të hedhura gabim	19	20	15	12	66
1 Hysni Kudret Sharra	2.548	3.110	2.916	3.228	11.802
2 Ertmal Neki Dredha	7.405	6.291	6.923	7.652	28.271
<b>Totali i votave të vlefshme</b>	<b>9.953</b>	<b>9.401</b>	<b>9.839</b>	<b>10.880</b>	<b>40.073</b>





## ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

### TABELLË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

#### BASHKIA VLORË, QARKU VLORË

Lidhja 2

	ZAZ 83	ZAZ 84	ZAZ 85	ZAZ 86	TOTALI
1 Nr Zgjedhëse në listë	46084	38347	41734	41523	167.688
2 Fletë votimi të gjetura në kuti	10276	9787	10144	11285	41.492
3 Vota të pavlefshme	333	339	334	368	1.374
4 Vota të vlefshme	9934	9430	9803	10907	40.074
5 Fletë votimi të hedhura gabim	9	18	7	10	44
1 Bashkë Fitojmë	1368	1660	1692	1886	6606
2 Partia Socialiste e Shqipërisë	6153	5377	5955	6604	24089
3 Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	221	298	191	205	915
4 Partia Republikane Shqiptare	338	205	187	160	890
5 Partia Levizja e Legaltetit	28	35	22	31	116
6 Partia Demokracia Sociale	218	122	265	117	722
7 Aleanca Liberale e Djathtë	10	25	11	17	63
8 Partia Socialdemokrate	100	193	181	208	682
9 Partia Demokratike	585	626	562	716	2489
10 Aleanca Progressiste L.ZH.K	648	112	92	162	1014
11 Fryma e Re Demokratike	62	144	195	154	555
12 Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	133	460	324	574	1491
18 Partia Balli Kombëtar	70	173	126	73	442
	<b>9.934</b>	<b>9.430</b>	<b>9.803</b>	<b>10.907</b>	<b>40.074</b>

